



## Qëllimi dhe Fusha e Zbatimit Neni 1

Ky Udhëzim rregullon formimin, procedurat dhe funksionimin e klubeve studentore të cilët zhvillojnë aktivitetin e tyre në bashkëpunim me Zyrën e Koordinimit të Klubeve Studentore dhe nën varësinë e Zyrës së Dekanit të Studentëve dhe kanë si qëllim aktivizimin e studentëve në programe jo mësimore shkencore, sociale, kulturore dhe sportive.

## Bordi i Lartë Neni 2

Bordi i Lartë, përbëhet nga Dekani i Studentëve, një anëtar i stafit akademik i emëruar nga Rektori, një anëtar i personelit i caktuar nga Përgjegjësi i Zyrës së Dekanit të Studentëve si dhe nga një përfaqësues i zgjedhur nga këshilli studentor. Bordi i Lartë përcakton rregullat e përgjithshme të aktivitetit të klubeve, vlerëson rastet e ngritjeve të klubeve të reja, kontrollon aktivitetet e klubeve dhe në raste të nevojshme i propozon Rektoriatit mbylljen e klubeve.

## Formimi i Klubeve Neni 3

Për formimin e një klubi duhet të mblidhen të paktën 7 studentë të cilët dorëzojnë në Zyrën e Dekanit të Studentëve, draft-statutin dhe një dokument të nënshkruar ku një anëtar i stafit akademik ose administrativ pranon të jetë këshilltar i klubit. Fusha e aktivitetit të parashikuar në Statut nuk mund të jetë e ngjashme me atë të një klubi të formuar më parë. Aplikimi shqyrtohet nga Bordi i Lartë i cili nëse e çmon të nevojshme formon një Klub në Provë. Klubi në provë ka të njëjtat të drejta dhe detyrime si klubet e tjera. Ky klub duhet që brenda 15 ditëve nga formimi të përcaktojë Rregullat e Përgjithshme dhe deri në përfundim të vitit akademik në të cilin është formuar të zgjedhë organet e tij. Klubi duhet që gjatë aktivitetit të tij të zhvillojë veprimtari në përputhje me qëllimin e formimit dhe të shtojë numrin e anëtarëve të tij. Në përfundim të statusit të kandidatit, aktivitetet e organizuara vlerësohen nga Bordi i Lartë. Në përfundim të vlerësimit vendoset nëse do të përfundojë statusi i kandidatit dhe do të formohet klubi apo nëse do të shpërndahet.

## Aktivitetet e Klubeve Neni 4

Periodha e zhvillimit të punimeve të klubit është vjetore, e barabartë me vitin akademik në Universitet.

- Aktiviteti i klubit zhvillohet në përputhje me Rregullat e Përgjithshme të përcaktuara nga Bordi i Lartë.
- Me synim realizimin e qëllimeve themelore të përcaktuara në pikën 1 të këtij udhëzimit klubi krahas aktiviteteve brenda fushës së përcaktuar në statut, mund të zhvillojë aktivitete të cilat sjellin të ardhura më qëllim mbulimin e këtyre aktiviteteve ose mund të kryejë prezantime.
- Organi kompetent në klub, në fillim të vitit akademik i paraqet Zyrës së Dekanit të Studentëve programin e aktiviteteve të parashikuara për atë vit. Draft programi dhe buxheti,

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Dekanati i studentëve	Këshilli i sigurimit të cilësisë	Këshilli i lartë



paraqet kostot e parashikuara për zhvillimin e aktiviteteve të klubit dhe të ardhurat duhet të përdoren me qëllim mbulimin e këtyre shpenzimeve.

- d) Klubi është i detyruar të dorëzojë pranë Zyrës së Dekanit të Studentëve dhe Zyrës së Financës në Shkollën e Lartë “Hëna e Plotë” Bedër një dokument të detajuar dhe bilacin për aktivitetet e zhvilluara deri në përfundim të vitit akademik. Klubet të cilat nuk kanë paraqitur këto dokumente nuk mund të vazhdojnë aktivitetin e tyre në vitin e ardhshëm akademik.
- e) Për aktivitetet e klubit të parashikuara në ligj, Statut, Rregullore ose akte të ngjashme dhe për prezantimin, njoftimin, reklamimin e tyre brenda dhe jashtë Shkollës së Lartë “ Hëna e Plotë” Bedër, klubi duhet të marrë miratimin e Zyrës së Koordinimit të Klubeve Studentore.
- f) Klubet, pasi plotësojnë “Formularin e Kërkesës për Zhvillimin e Aktivitetit”, i cili merret në web site-n e Shkollës së Lartë “ Hëna e Plotë” Bedër, me kodin personal të klubit, dorëzojnë formularin e plotësuar në Zyrën e Koordinimit të Klubeve Studentore për miratim.
- g) Klubet nuk mund të zhvillojnë aktivitete të cilat dëmtojnë hapsirën fizike të Shkollës së Lartë “ Hëna e Plotë” Bedër, ose pengojnë zhvillimin e rregullt të aktivitetit akademik.
- h) Klubet nuk duhet të tejkalojnë fushën e veprimtarisë së tyre si dhe nuk duhet të futen në fushën e klubeve të tjera.
- i) Në rast se Përgjegjësi i Zyrës së Koordinimit të Klubeve Studentore e gjykon të arsyeshme mund të kërkojë mendimin e këshilltarit të klubit për publikimet e klubit ose aktivitetet e tjera.

### **Anëtarësia në Klube Neni 5**

- a) Anëtarësimi në klube është i hapur vetëm për studentët. Një student mund të jetë anëtar i më shumë se një klubi në të njëjtën kohë dhe mund të marrin pjesë në punimet e klubit të preferuar. Studentët e diplomuar mund të marrin pjesë si anëtarë nderi.
- b) Anëtarësia përcaktohet në fillim të çdo semestri pas realizimit të regjistrimit. Anëtarësia përcaktohet nga Këshilli i Përgjithshëm në përfundim të vitit akademik paraardhës. Anëtarësia rinovohet në fillim të çdo viti akademik.
- c) Anëtarësia mund të jetë në formë aktive ose në formë pasive. Anëtarët aktiv janë ata anëtarë të cilët të paktën për dy semestra kanë kryer aktivitete në përputhje me kriteret e anëtarësisë aktive të përcaktuara në statut. Në rast mospërbushjeje të këtyre kushteve ato figurojnë si anëtarë pasiv. Anëtarët pasiv nuk kanë të drejtën e votës.
- d) Personat të cilët nuk plotësojnë kushtet për njohjen si anëtarë, mund të marrin pjesë në aktivitetet e klubit me statusin e anëtarit të ftuar, këshilltarit ose si trajner. Këta persona zgjidhen me vendim të shumicës absolute të Këshillit të Përgjithshëm dhe me miratim të Zyrës së Dekanit të Studentëve, por nuk kanë të drejtë të votojnë, të zgjedhin ose të zgjidhen. Anëtarësia në formën e trajnerit ose këshilltarit duhet të rinovohet çdo vit. Në rastet e nevojshme Zyra e Dekanit të Studentëve mund të vendosi ti japë fund detyrës së tyre gjatë vitit akademik.
- e) Përfundimi nga anëtarësia, bëhet me propozim të Bordit Drejtues, me aprovimin e dy të tretës të Këshillit të Përgjithshëm të Klubeve dhe me miratim të Zyrës së Dekanit të Studentëve.

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Deknati i studentëve	Këshilli i sigurimit të cilësisë	Këshilli i lartë



- f) Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në kuadër të klubit, kandidatët për anëtar, anëtarët ose klubet mund ti drejtohen Zyrës së Dekanit të Studentëve.

## STATUTI I KLUBEVE

### Neni 6

Statuti i klubeve përgatitet në përputhje me rregullat e këtij Udhëzimi dhe me rregullat e përgjithshme të përgatitura nga Bordi Drejtues i Klubit. Ndryshimet në Statut mund të bëhen nëse propozohen ndryshime nga dy e treta e të gjithë anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm ose propozohet nga Bordi i Lartë. Propozimi pranohet vetëm në rast se për të voton pro dy e treta e Këshillit të Përgjithshëm. Hyrja në fuqi e ndryshimeve të bëra në statut përcaktohet në vendimin e Këshillit të Përgjithshëm.

## Organet e Klubit

### Neni 7

Organet e klubeve janë: Këshilli i Përgjithshëm dhe Bordi Drejtues.

#### A) Këshilli i Përgjithshëm dhe Detyrat

- Është organ vendimmarrës i përgjithshëm i klubit. Përbëhet nga anëtarët aktiv të klubit. Me kërkesë të Bordit të Lartë mund të mbledhet të paktën një herë në semestër. Me kërkesë të një të tretës së anëtarëve aktiv të klubit, Bordi i Lartë mund të thërrasë mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm.
- Në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm duhet të jenë të pranishëm më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve. Në rast të mosplotësisë të shumicës absolute, në mbledhjen e radhës nuk kërkohet shumicë. Në rast të mos përcaktimit të një shumice të caktuar, vendimet merren me shumicë të anëtarëve të pranishëm.
- Në rastet e mos realizimit të mbledhjes së Këshillit të Përgjithshëm sipas programit të caktuar, Përgjegjësi i Zyrës së Dekanit të Studentëve ka të drejtë të pezullojë aktivitetet e klubit.
- Këshilli i Përgjithshëm në përfundim të çdo viti akademik, vendos për vitin pasardhës në lidhje me zgjedhjen e anëtarëve kryesorë dhe shtesë të Bordit Drejtues.
- Vendos në lidhje me propozimet për përjashtim nga anëtarësia.
- Miraton anëtarët e nderit, këshilltarët dhe trajnerët.
- Miraton draft-programin e aktiviteteve të parashikuara për vitin akademik.
- Miraton ndryshimet në statut.

#### B) Bordi Drejtues i Klubit dhe Detyrat

- Bordi Drejtues është organi administrativ i klubeve. Në ditën e fundit të leksioneve në përfundim të çdo viti akademik, Këshilli i Përgjithshëm zgjedh presidentin, zëvendës presidentin, një arkëtar dhe një sekretar dhe të paktën një anëtar tjetër. Presidenti i zgjedhur mund të qëndrojë në detyrë për dy vite akademike rradhazi, por studentët e programeve pasuniversitare nuk mund të jenë kryetar klubi.

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Dekani i studentëve	Këshilli i sigurimit të cilësisë	Këshilli i lartë



- b) Gjatë zgjedhjes së Bordit Drejtues, për çdo anëtar zgjidhet një zëvendës anëtar. Në rast të largimit të anëtarit kryesor para mbarimit të afatit, në vend të tij kalon anëtari rezervë duke marrë parasysh shumën e votave që ka marrë. Anëtarët rezervë mund të marrin pjesë në mbledhjen e Bordit Drejtues por nuk kanë të drejtë vote dhe nënshkrimi. Emrat e anëtarëve të zgjedhur të Bordit Drejtues i njoftohen Zyrës së Dekanit të Studentëve.
- c) Anëtarët aktivë kryesor ose rezervë të Bordit Drejtues mund të marrin pjesë në Bordin e Drejtues të një klubi tjetër. Studentët të cilët kanë përfunduar 8 semestra në Shkollën e Lartë “Hëna e Plotë” Bedër nuk mund të jenë anëtarë të Bordit të Drejtues.
- d) Bordi Drejtues mund të ftojë në mbledhje Këshilltarin dhe anëtarë të tjerë të ftuar. Këta persona nuk kanë të drejtë vote.
- e) Anëtarët aktivë të Bordit Drejtues mund të përjashtohen nga detyra me një shumicë prej dy të tretash të Këshillit të Përgjithshëm.
- f) Bordi Drejtues është përgjegjës përpara Këshillit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Dekanit të Studentëve për mbarëvajtjen e punëve në klub, për zbatimin e statutit, anën financiare të klubit dhe materialet në përdorim.
- g) Klubi është i detyruar të dorëzojë në fillim të vitit akademik draft-buxhetin dhe programin e aktiviteteve të parashikuara dhe në përfundim të vitit raportin e aktivitetit dhe bilancin pranë Zyrës së Dekanit të Studentëve.
- h) Kontrollon raportin vjetor të aktivitetit të klubit, dokumentacionin, dhe gjëndjen e materialeve.
- i) Me vendim të Bordit të Lartë kontrollon të ardhurat dhe shpenzimet e parashikuara në statut dhe draft buxhet.

### **Detyrat e këshilltarit të klubit** **Neni 8**

- a) Të udhëzojë studentët mbi funksionimin e klubit studentor.
- b) Jep këshilla për çështje të ndërlikuara të klubit studentor.
- c) Analizon veprimtarinë e klubit dhe bën propozime në lidhje me përmirësimin e veprimtarisë së klubit.
- d) Jep këshilla mbi zhvillimin e cilësisë së aktiviteteve të klubit.
- e) Të kryejë detyra të tjera të caktuara nga Zyra e Dekanit të Studentëve.

### **Detyrat e arkëtarit të klubit** **Neni 9**

- a) Të menaxhojë të ardhurat dhe buxhetin e klubit.
- b) Të regjistrojë të gjitha faturat në regjistrin e të ardhurave të klubit.
- c) Të kryejë pagesat përkatëse të aktiviteteve dhe veprimtarive të klubit.
- d) Përgjigjet për regjistrimin e materialeve të blera në Zyrën e Çështjeve Administrative.
- e) Të kryejë detyra të tjera të caktuara nga Zyra e Koordinimit të Klubeve Studentore.

### **Dokumentat e Klubit**

#### **Neni 10**

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Dekanati i studentëve	Këshilli i sigurimit të cilësisë	Këshilli i lartë



- a) **Lista e regjistrimit të anëtarëve:** Është dokumenti ku pasqyrohen emrat dhe mbiemrat e anëtarëve, numrat e studentëve, kontaktet dhe datën e anëtarësimit në klub. Kjo listë e cila duhet të jetë e arkivuar në mënyrë të shkruar në arkivin e klubit, duhet të dorëzohet në fillim të vitit akademik pranë Zyrës së Dekanit të Studentëve. Kjo listë përditësohet çdo semestër.
- b) **Procesverbali i mbledhjes:** Është dokumenti ku pasqyrohen vendimet e marra në mbledhjet e Bordit të Administrimit, Këshillit të Përgjithshëm, dhe Bordit Drejtues. Pas zbardhjes së vendimeve procesverbali nënshkruhet nga anëtarët e organit përkatës.
- c) **Listprezenca e mbledhjes:** Është dokumenti në të cilin janë shënuar anëtarët e organeve përkatëse dhe duhet nënshkruar nga çdo anëtar që merr pjesë në mbledhje.
- d) **Axhenda e mbledhjes:** Është dokumenti në të cilin pasqyrohet rendi i ditës që do të diskutohet në mbledhje.
- e) **Regjistri i materialeve:** Është dokumenti në të cilin regjistrohen materialet e klubit.
- f) **Regjistri i të ardhurave:** Është dokumenti në të cilin regjistrohen të ardhurat e klubit.

### Dispozita financiare Neni 11

- a) Të gjitha shpenzimet dhe të ardhurat nga aktivitetet të cilat dokumentohen, duhet të dorëzohen në përfundim të vitit së bashku me raportin vjetor të aktivitetit pranë Zyrës së Dekanit të Studentëve.
- b) Klubet janë të detyruara të miratojnë paraprakisht të gjitha marrëveshjet e sponsorizimit të paktën një javë përpara pranë Zyrës së Dekanit të Studentëve. Në raste të nevojshme Zyra e Dekanit të Studentëve shqyrton marrëveshjen duke marrë mendimin e një eksperti ligjor si dhe njofton dhe merr mendimin e Rektoratit.
- c) Pajisjet e zyrës të ofruara nga Shkolla e Lartë “Hëna e Plotë” Bedër, i dorëzohen Kryetarit të klubit nga Zyra e Çështjeve Administrative. Klubi duhet të njoftojë Zyrën e Çështjeve Administrative brenda 15 ditëve nga marrja në dorëzim e mallrave të reja dhe duhet që pasi të marrë numrin e materialit ta regjistrojë atë në rregjistër. Materiali nuk mund të përdoret jashtë ambienteve të klubit.
- d) Klubi duhet të ruajë të gjitha faturat, marrëveshjet dhe dokumentacionin që lidhet me shpenzimet dhe të ardhurat e klubit.

### Përfundimi dhe mbyllja Neni 12

- a) Çdo klub mund të vendosë përfundimin e aktivitetit të tij me miratim të Këshillit të Përgjithshëm. Klubi njofton me shkrim Zyrën e Dekanit të Studentëve për vendimin e mbylljes së tij. Klubi i cili përfundon ose mbyll aktivitetin e tij është i detyruar ti dorëzojë Zyrës së Dekanit të Studentëve, bilancin, dokumentat dhe të gjitha materialet e marra në dorëzim.
- b) Klubet të cilat zhvillojnë aktivitetin e tyre në kundërshti me Rregullat e Përgjithshme të përcaktuara nga Bordi Drejtues mund të mbyllen me vendim të këtij të fundit. Në rastet kur veprimet e drejtuesve të klubit dhe anëtarëve të tij përbëjnë shkak për nisjen e procesimit disiplinor ato nuk mund të pranohen si anëtarë në klube të tjera.
- c) Klubi i studentëve mbyllet në rast se kryen aktivitete në kundërshtim me rregullat e përgjithshme, shtetërore të moralit si dhe më legjislationin në fuqi, bazën ligjore të Shkollës së Lartë “Hëna e Plotë” Bedër, Rregulloret dhe Udhëzimet. Kryetari i klubit dhe të gjithë

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Dekanati i studentëve	Këshilli i sigurimit të cilësisë	Këshilli i lartë



- anëtarët bëhen subjekt i procedimit disiplinor sipas “Rregullores mbi Disiplinën e Studentëve”, dhe në rast të nevojshëm ndaj tyre mund të nisët procedimi disiplinor në organet kompetente.
- d) Klubet të cilët brenda dy muajve nga fillimi i vitit akademik nuk zhvillojnë aktivitete në bazë të programit, nuk dorëzojnë raportin e punës në fund të vitit akademik pranë Bordit të Lartë, nuk zhvillojnë mbledhjet e Këshillit të Përgjithshëm të përcaktuara në statut ose nuk kryejnë veprimtari në përputhje me qëllimin e krijimit, paralajmërohen në mënyrë të shkruar nga Bordi i Lartë. Klubi i cili nuk dorëzon dokumentet e kërkuara pavarësisht paralajmërimit mbyllet.
  - e) Në rast se numri i anëtarëve aktivë të klubit, bie nën 15 në dy vite të njëpasnjëshme, aktivitetit të klubit i jepet fund.
  - f) Në rast se gjatë një semestri klubi nuk kryen të paktën një kontribut/aktivitet ose ata që kryejnë vetëm një kontribut/aktivitet me qëllim mos përfshirjen në këtë nen paralajmërohen nga Zyra e Dekanit të Studentëve; në rast se edhe në semestrin pasardhës klubi nuk kryen asnjë kontribut/aktivitet, ai mbyllet. Përgjegjësi i Zyrës së Dekanit të Studentëve, për shkelje të këtij udhëzimi ka të drejtë të drejtë të japë paralajmërime, të mos japë leje për aktivitete të ngjashme, të pushojë nga puna përgjegjësit, të kufizojë aktivitetin e klubit brenda fushës së përcaktuar në statut, të pezullojë ose pushojë aktivitetin e klubit si dhe në raste të nevojshme të marrë masa parandaluese dhe të sigurojë zbatimin e tyre.

### **Hyrja në fuqi Neni 13**

Ky Udhëzim hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli i Lartë. Të gjitha klubet e reja dhe ato që tashmë zhvillojnë aktivitetin e tyre në Shkolla e Lartë “Hëna e Plotë” Bedër janë të detyruara të përshtasin aktivitetin e tyre me këtë udhëzim.

### **Zbatimi Neni 14**

Zbatimi i këtij Udhëzimi mbikqyret nga Rektori i Shkollës së Lartë “Hëna e Plotë” Bedër.

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Dekanati i studentëve	Këshilli i sigurimit të cilësisë	Këshilli i lartë